



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Nr. 3921/Prot
11

29-12-18

Tiranë, më 18/12/2018

Lënda: Propozim për emërimin e Kryetarit të Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë.

Zotit Gramoz RUÇI

KRYETAR I KUVENDIT TË SHQIPËRISË

I nderuar Zoti Kryetar,

Kuvendi i Shqipërisë me Vendim nr. 6/2014 datë 6.2.2014, ka zgjedhur Z.Petrit AHMETI kryetar të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE). Mandati i Z.Petrit AHMETI, si kryetar i Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) *përfundon më 06.02.2019.*

Sa më sipër, pas përfundimit të afatit të paraqitjes së kandidaturave, në vijim të procedurave për emërimin e kryetarit të Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë:

Ekipi Përzgjedhës, bazuar në nenin 11, pika 4 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i propozon Kuvendit të Shqipërisë për pozicionin e kryetarit të Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë kandidaturat e mëposhtme:

- 1. Z.Petrit AHMETI**
- 2. Z.Agim NASHI**

Kandidaturat e propozuara plotësojnë kushtet e parashikuara në nenin 11 pika 5/a, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe kanë njohuritë, eksperiencën dhe formimin e nevojshëm për të realizuar detyrën.

Bashkëlidhur CV-të e kandidaturave.

EKIPI PERZGJEDHES

Damian Gjiknuri

Ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

Eduard Shalsi

Kryetar i Komisionit për Veprimtaritë
Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Erion Braçe

Kryetar i Komisionit për
Ekonominë dhe Financat

PROCES – VERBAL

I mbajtur në mbledhjen e Ekipit Përzgjedhës, më datë 20.12.2018 Për propozimin e kandidaturave për anëtar të Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë

Ekipi Përzgjedhës në cilësinë e propozuesit të anëtarëve të Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë, bazuar në nenin 11, pika 4 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i propozon Kuvendit të Shqipërisë, dy kandidatura për pozicionin e anëtarit të Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë, si më poshtë:


- 1. Z.Maksim SHULI**
- 2. Z.Mynyr SINANAJ**

Kandidaturat e propozuara plotësojnë kriteret ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 5/c, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, për vendin e anëtarit të ERE-së.

I propozojmë këto kandidatura për të vijuar procedurat parlamentare, në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Damian Gjiknuri

Ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë



Eduard Shalsi

Kryetar i Komisionit për Veprimtaritë
Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Erion Braçe

Kryetar i Komisionit për
Ekonominë dhe Financat

